



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
**Komisioneri**

---

Nr. 14/2 Prot.

Tiranë, më 18/5/2011

**Lënda:** Rekomandim për “**Albtelekom**” sh.a.

**REKOMANDIM**

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, “**Albtelekom**” sh.a,

**KONSTATOVA**

Më datë 21.03.2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, “**Albtelekom**” sh.a, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Të dhënat personale që përpunohen (kategoritë e subjekteve, klientë punonjës etj.).
- Zbatimi i kushteve dhe kritereve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Si zbatohen të drejtat e subjekteve të të dhënave personale të parashikuara në nenet 12, 13, 14, 15, 16, 17, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21).
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).
- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese?

Komisioneri "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

1. Kontrolluesi "Albtelekom" sh.a kategorizon si "klientë" të gjithë individët, subjektet fizike dhe juridike të cilët marrin nga kjo kompani (kontrollues) shërbimin për telefoninë fikse dhe shërbimin e internetit.

Në zbatim të ligjit nr. 9918 dt. 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) ka miratuar **formularë regjistrimi (tip)** "Për përdorimin e shërbimit publik të qëndrueshëm (fiks)", "Kontrata e pajtimtarit për shërbimin publik telefonik fiks" dhe "Kontrata për shërbimin akses në internet ADSL".

U konstatua se, kontrolluesi "Albtelekom" sh.a, mbledh dhe depoziton në dosjet e klientëve dokumentacione me të dhëna personale të klientëve që nuk parashikohen në kontratën tip të miratuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike si (çertifikatë pronësie të banesës, kontrata shitblerje, qiraje, vërtetim banimi etj..)

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 5 pika 1/b,c i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"... b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime; c) të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim".

Për sa më sipër, duhet të zbatohet një balancë ndërmjet të drejtës për të përcaktuar përdorimin e të dhënave personale të klientit dhe interesave të kontrolluesit. Pavarësisht faktit që klientët japin me vullnetin e tyre të dhënat personale, asnjë klient si subjekt i të dhënave personale nuk do të donte përpunimin e të dhënave të tij personale dhe sigurisht që ato kërkojnë që të dhënat e tyre të përpunohen në mënyrë konfidenciale.

Pavarësisht qëllimit për të cilin ky kontrollues mbledh dokumentacione shtesë më të dhëna personale të klientëve, ai duhet të respektojë plotësisht formularët dhe kontratat tip të miratuara nga ana e AKEP-it , pasi në këtë rast nuk respektohet neni 5 pika 1/b,c i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

2. Kontrolluesi "Albtelekom" sh.a, mban në arkiva fizike dosje me dokumente që mbartin të dhëna personale të klientëve që kanë zgjidhur prej vitesh kontratën me këtë kompani dhe nuk kanë detyrime financiare me të (duke mos qenë në këtë mënyrë debitorë më këtë kontrollues), dosjet e të cilëve (debitorëve) kontrolluesi i ka arkivuar në një sistem të veçantë.

Për dosjet e klientëve të kësaj natyre, nga ana e kontrolluesit u deklarua se nuk kanë udhëzim apo rregullore të veçantë për mënyrën dhe kohën e ruajtjes se dosjeve dhe se këto dosje trajtoheshin njësoj si dosjet e klientëve aktivë.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 5 pika 1/b,c i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"... "Në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa



*është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej” dhe neni 27/4 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”... “Dokumentacioni i të dhënave mbahet për atë kohë sa është e nevojshëm për qëllimin për të cilin është grumbulluar”.*

3. Kontrolluesi “Albtelekom” sh.a krahas krijimit dhe arkivimit të dosjeve për kategorinë klient, përdor dhe sistemin kompjuterik për regjistrimin dhe përpunimin e të dhënave personale të klientëve. Kështu u konstatua që punonjësit e pikave të shitjes krahas krijimit të një dosje me dokumentacionin shkresor me të dhëna personale të klientëve, hedh në sistemin kompjuterik të kontrolluesit një pjesë të të dhënave për secilin klient të cilat përbëjnë bazën e punës të departamentit të faturimit ( billing).

Gjithashtu u konstatua se, për qëllime të faturimit të konsumit për klientët kontrolluesi “Albtelekom” sh.a ka instaluar para katër vitesh një program elektronik Austriak nëpërmjet të cilit të dhënat e skedarëve (tablatet) mbahen në rrjet aktiv 3-muaj dhe pastaj ruhen të arkivuara në hardisk (storage) dhe CD-ROM. Që nga instalimi i këtij programi kontrolluesi nuk ka bërë shkatërrimin e të dhënave që mbarten në skedarë.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 101 të ligjit nr. 9918 dt. 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe për rrjedhojë dhe nenin 5 pika 1/d i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”... “Në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej”, si dhe nenin 27/4 ... “Dokumentacioni i të dhënave mbahet për atë kohë sa është e nevojshëm për qëllimin për të cilin është grumbulluar”.

Në arkivat telefonike të kontrolluesit “Albtelekom” sh.a mbeten shenjat e telefonatës, numri, përgjigja e telefonuesit ose shenja që linja është e zënë dhe përgjigja e munguar. “Albtelekom” sh.a memorizon (jo më shumë se 6 muaj me përjashtim në ndonjë rast kur janë duke u zhvilluar hetime ) atë çka është e nevojshme për të faturuar shërbimin klientit. Ruan në radhë të parë të ashtuquajturit të dhëna të trafikut: numrin e të thirrurit, datën, orën dhe kohëzgjatjen e telefonatës. Bëhet fjalë për informacione të quajtura “të jashtme” në lidhje me atë çka flitet në brendësi. Por kjo nuk do të thotë që këto informacione janë më pak të rëndësishme në lidhje me privatësinë e një individi, pasi këto të dhëna japin mundësinë për të ndërtuar komplet rrjetin tonë të miqësisë dhe atë profesional. Duke parë të dhënat e trafikut të telefonatave kuptohen menjëherë numrat që merren më shpesh ( domethënë njerëzit që u telefonohet më shpesh) në një periudhë të caktuar, duke krijuar një panoramë të qarte mbi miqësitë, tradhtitë, zakonet, anëtarësime në sindikata apo subjekte politike, për ke subjekt je militant etj. Duhet kuptuar se liria dhe privatësia e telefonatave përbëjnë një të drejtë të individit i cili bën pjesë në vlerat kryesore të Kushtetutës, Ajo është e lidhur ngushtë me thelbin kryesor të dinjitetit njerëzor dhe me zhvillim e personalitetit në shoqëri dhe për këtë arsye duhet mbrojtur jo



vetëm privatësia e përmbajtjes së telefonatave por dhe çka ka lidhje me identifikimin e subjekteve dhe çdo lidhje që mund të ketë me kohën dhe vendin e telefonatës. Për këtë arsye njihet e drejta për të mbajtur kofidenciale si të dhënat që çojnë në identifikimin e subjektit por dhe kohëzgjatja dhe vendi i vetë komunikimit. Në një sistem demokratik të gjithë qytetarët duhet të ndihen të lirë të komunikojnë dhe të shprehen dhe në qoftë se nuk respektohet "hapësira jetësore" e personit dinjiteti i këtij të fundit atëherë është lënduar.

Operatorët telefonike menaxhojnë miliarda informacione personale dhe janë në gjendje të zhveshin totalisht çdo qytetar. Kur ndërtohen arkiva të mëdhenj elektronik qofshin këto me të dhëna publike apo private, të drejtat e njeriut vihen në rrezik. Sa më të mëdhenj të jenë arkivat, aq më të mëdha janë dëmet në rast abuzimesh. Kur në kontrollues të ndryshëm nuk vendosen sisteme të përshtatshme të sigurisë të cilat janë të detyrueshme me ligj, krijohet mundësia që persona të paautorizuar ose të autorizuar por që veprojnë për qëllime jo të lejuara, të marrin informacion pa lënë gjurmë, domethënë pa qenë në gjendje të përcaktojmë shkelësin e ligjit.

Këto të dhëna mund të përdoren për qëllime të paligjshme por janë dhe një ndihmë shumë e madhe për hetime të prokurorisë. Në fakt "Albtelekom" sh.a ka për detyrë t'i ruajë të dhënat telefonike për një kohë dy vjeçare (sipas nenit 101 të ligjit "Për komunikimet elektronike") për ti vënë në dispozicion të organeve të Prokurorisë nëse do ju duhet të kuptojnë rrjetin e lëvizjeve apo të kontaktit të një grupi njerëzish.

Mos respektimi i afateve ligjore të ruajtjes dhe administrimit të skedarëve me të dhëna personale të pajtimtarëve lë shteg për abuzime në lidhje me të dhënat e tyre.

4. Kontrolluesi "Albtelekom" sh. a nuk ka përfshirë në marrëveshjet e lidhura me përpunues të ndryshëm (Banka, Posta Shqiptare etj..) rregulla të qarta mbi të drejtat dhe detyrat e përpunuesit për garantimin e përdorimit të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale të klientëve të tij.

- Nuk respektohet neni 20 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Mbi detyrimet e përpunuesit.

5. Kontrolluesi "Albtelekom" sh. a në formularin e njoftimit të depozituar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nuk ka deklaruar mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale për kategorinë "Furnizues"

- Nuk është zbatuar neni 21 pika 1 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... "Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë".

6. Kontrolluesi "Albtelekom" sh.a mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të video survejimit (CCTV) në ambiente të punës ( zyra me më shumë se 5- së punonjës) dhe korridore, duke mos e argumentuar në mënyrë bindëse si



dhe proporcionale vendosjen e tyre, si dhe të pa shprehur në një aktmarrëveshje me sindikatën e punonjësve.

Përfaqësuesi i kontrolluesit deklaroi gjatë intervistimeve se, qëllimi i përdorimit të videosurvejimit në kato ambiente pune është për të garantuar sigurinë e dokumentacionit që përdorin punonjësit në punën e tyre. Dokumentacioni me të cilin ata punojnë ka të bëjë me informacione të rëndësishme ekonomike të kontrolluesit( hedhja në sistem e informacioneve lidhur me konsumin për klientët , informacione për kofidencialitetin e të dhënave të klientëve etj.

Grupit të kontrollit administrativ ju deklarua se kontrolluesi nuk ka pasur raste të humbjes apo dëmtimit të dokumentacionit, por ai është nisur nga numri i madh i punonjësve në këto ambiente i cili rrit mundësinë e ndodhjes së rasteve të dëmtimit apo humbjes së dokumentacioneve. Kontrolluesi mendon se përdorimi i këtij sistemi do të garantojë një siguri të dokumentacionit dhe u shpreh se nuk ka marrë mendimin e punonjësve apo të sindikatës lidhur me përdorimin e këtij sistemi në këto ambiente pune.

Kontrolluesi mund të përdorë sistemin e video survejimit nëse kjo është e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe të pronës, për të siguruar dhe mbikëqyrur hyrjet dhe daljet në ndërtesë, ose nëse natyra e punës mund të sjellë një kërcënim potencial për kontrolluesin. Në këtë rast kontrolluesi duhet të ketë një vendim të shkruar ku të shpjegojë arsyet pse do të futet në përdorim sistemi i video survejimit, qëllimi dhe mënyra e përdorimit të tij në ambientet e punës ose ambiente të tjera (korridore).Të gjithë punonjësit që punojnë nën vëzhgimin e kamerave duhet të njoftohen nga punëdhënësi me shkrim ose për përdorimin e këtij sistemi të jetë marrë paraprakisht mendimi i sindikatës.

Kamerat e sigurisë mund të vendosen në ambientet e punës vetëm në raste të veçanta, kur nevojitet për sigurinë e njerëzve dhe pronës dhe kur ky qëllim nuk mund të arrihet me mënyra të tjera më të arsyeshme, duke pasur parasysh zbatimin e parimit të proporcionalitetit në raportin midis privatësisë së subjekteve të të dhënave personale dhe qëllimit të kontrolluesit.

Kontrolluesi kur vendos të përdorë sistemin e videosurvejimit duhet ta mbështesë atë mbi baza të duhura ligjore dhe nuk duhet të shkelë privatësinë dhe të keqpërdorë të dhënat personale të punonjësve.

Çdo punonjës ka të drejtën të gëzojë një shkallë të caktuar privatësie në punë. Qëllimi, për të cilin përfaqësuesit e kontrolluesit deklaruan gjatë intervistimit, mund të realizohet mjaftueshëm me vendosjen e kamerave të regjistrimit në hyrjet- daljet e godinës së punës të kontrolluesit dhe nuk është e nevojshme përdorimi i tyre në brendësi të zyrave të punonjësve.

Është e panevojshme që sistemi i video surveimit të përdoret në këto ambiente pasi kemi të bëjmë me një lloj interferimi në jetën private të punonjësve.

Përdorimi i video regjistrimeve në zyra nuk është i nevojshëm në rastin konkret, pasi punonjësit që punojnë në këto zyra nuk përbëjnë shkallë të lartë rreziku (për vetë natyrën e punës) sa të justifikohet përdorimi i videosurvejimit në këto ambiente.

Përfundimisht, konsiderojmë si jo proporcionale me qëllimin për të cilin është instaluar përdorimin e video kamerave (CCTV-ve) në zyrat e punonjësve si një mungese të theksuar të ruajtjes së jetës private, dinjitetit, pavarësisë, vlera këto të shprehura në

“Deklaratën e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut “ dhe parimit të mjaftushmerisë të shprehur në ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 ”Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Nga kontrolli administrativ u konstatua se kontrolluesi “Albtelekom” sh.a nuk ka të shkruara, procedura të qarta për të përcaktuar përdorimin e këtij sistemi në praktikë, ku të ketë të identifikuar dhe përcaktuar qartë qëllimin specifik për përdorimin e këtij sistemi dhe të dhënave personale që do të mblidhen, përpunohen e do të trajtohen në praktikë ( udhëzime për vënien në dispozicion të regjistrimeve dhe mënyrën e ruajtjes së tyre, aksesin etj) si dhe rregulla të shkruara lidhur me konfidencialitetin e të dhënave personale.

7. Kontrolluesi “Albtelekom” sh.a nuk ka hartuar rregullore për mënyrën e arkivimit dhe kohën e ruajtjes të dosjeve me dokumente që mbartin të dhëna personale të klientëve dhe punonjësve të tij.

Sa më sipër:

- Nuk respektohet neni 5 pika 1/c i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”... c) të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim...
- Nuk respektohet neni 27/1 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”... Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi...
- Nuk respektohet neni 28 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” Konfidencialiteti i të dhënave.
- Nuk zbatohet udhëzimi nr. 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

## REKOMANDOJ



1. Në zbatim të nenit pika 1/b, c të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*””, kontrolluesi “Albtelekom” të heqë nga dosjet e klientëve dokumentet që mbartin të dhëna personale (*certifikatë pronësie të banesës, kontrata shitblerje, qiraje, vërtetim banimi etj.*) të pa parashikuara në formularët tip të miratuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) dhe në të ardhmen të depozitojë vetëm dokumente që mbartin të dhëna personale për klientët, të parashikuar në formularin tip.
2. Në zbatim të neneve 5 pika 1/d dhe 27/4 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” sh.a. dhe nenit 101 të ligjit nr. 9918 dt. 19.05.2008 “*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*””, kontrolluesi “Albtelekom” të shkatërrojë të dhënat personale që mbarten në skedarët (tabulatet e komunikimeve telefonike) të pajtimtarëve (klientëve) të cilët kanë plotësuar afatin dy vjeçar të ruajtjes së këtyre të dhënave.
3. Në zbatim të neneve 5 pika 1/d dhe 27/4 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*””, kontrolluesi “Albtelekom” të shkatërrojë, nga arkiva i saj fizik, dosjet me dokumente që mbartin të dhëna personale të klientëve të cilët kanë zgjidhur prej vitesh kontratën me këtë kontrollues dhe nuk kanë probleme juridike apo financiare.
4. Në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*””, kontrolluesi “Albtelekom” të marrë masa për përfshirjen në kontratat dhe marrëveshjet e lidhur me përpunues të ndryshëm (Banka, Posta Shqiptare etj) rregulla të qarta mbi të drejtat dhe detyrat e përpunuesit për garantimin e përdorimit të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale të klientëve të tij.
5. Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, kontrolluesi “Albtelekom” të deklarojë në formularin e njoftimit të depozituar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale për kategorinë “*Furnizues*”.

6. Në zbatim të neneve 5/1,c , 27/1, të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” si dhe udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, kontrolluesi “Albtelekom” të ndalojë mbledhjen dhe përpunimin e dhënave personale të punonjësve nëpërmjet përdorimit të sistemit të video survejimit (CCTV) në ambiente e punës ( zyra me më shumë se 5- së punonjës) dhe korridore si dhe të hartojë rregullore të shkruar për qëllimin, mënyrat e mbledhjes dhe përpunimit, të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të video survejimit (CCTV).
7. Në zbatim të nenit 27/1 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “Albtelekom” të hartojë rregullore për mënyrën e arkivimit dhe kohën e ruajtjes të dosjeve me dokumente që mbartin të dhëna personale të klientëve dhe punonjësve të tij si dhe të përcaktojë rregulla të qarta për ruajtjen e konfidencialitetit dhe besueshmërinë për punonjësit që mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej 30 ditësh.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

